

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Rikonstruktion i rrugës së fshatit Dhivër me shtresë asfalti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 45000000-7 – Pune ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

8.333.333 (tetëmilionë e treqindë e tridhjetë e tremijë e treqindë e tridhjetë e tre) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formsë elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Vertetim të leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Per plotesimin e kriterit të mesiperm të pikes është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 80 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rëstin e paraqitjes së ofertës si Bashkim Operatorësh Ekonomike pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- Kontraten/at e Sipërmarrrjes,
- Situacion përfundimtarë të objektit,
- Faturat tatimore për çdo situacion,
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.8.
- Akti i Kolauditimit

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin se kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata për punë private të realizuar me subjekte private kërkohen:

- Kontraten/at e Sipërmarrjes,
- Situacion përfundimtar të objektit,
- Faturat tatimore për çdo situacion,
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat.
- Akti i Kolaudimit

Shënim: Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin se kontrata është realizuar me sukses.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori të paraqesë përveç dokumentave sa më lart edhe miratimin si nënkontraktor të dhënë nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që të jenë minimalisht në vlerat 20 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 80%, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që:

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Ne rastin konkret vlera e kërkuar nga AK është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve të kontratës, të lëshuar nga Ministrisë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas formatit të miratuar me VKM nr.42, datë 16.01.2008, në kategoritë sa më poshtë vijon:

- NP - 1 A Punime germimi ne toke
- NP - 4 A Rruge,autostrada,mbikalime ,hekurudha,pista aeroportuale
- NS - 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr.8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar, VKM Nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”e ndryshuar

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punëve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të liçences profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që ne kërkojmë të prokurojmë dhe pikat e kërkuara të licenses jane percaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit.Nisur nga fakti qe shumatorja e zërave të preventivit të punimeve që i përkasin sejcilës prej kategorive të punimeve eshte me e vogel se 20 milione leke , eshte zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” qe i pergjigjet kesaj vlere.

2.3.3 Referuar preventiv, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndertimore O.E duhet te kete te punesuar drejtues teknik punimesh si me poshte:

- Inxhinier Ndertimi - 1 (nje);
- Inxhinier Topograf - 1 (nje);

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve të mesiperm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjitha dokumentacionin provues si me poshte:

- Kontrata individuale e punes e vlefshme
- Diplomen perkatese
- Librezë pune
- CV

Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesit e mesiperm nuk duhet te figurojne te dy punesuar njëkohësisht ne sektorin publik dhe atë privat. Per kete administratori i operatorit ekonomik duhet te paraqese deklaraten perkatese. Mosparaqitja e ketij informacioni do te konsiderohet si kusht per skualifikim. (Autoriteti Kontraktor do te verifikojë saktësinë e informacionit).

Inxhinierat e mesiperm pjese e stafit duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise, sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga natyra e punimeve objekt i kontratës që prokurohet janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës inxhinierat e lartpërmendur.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e puneve publike objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 16 (gjashtembdhjete) persona** .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- Listpagesat sipas formularit satandart per sigurimet
- Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Sasia e oreve te punes mbeshetur ne preventiv, manualin e çmimeve te ndertimit dhe analizat e kostove eshte 4032 ore :8 = 504 dite pune . Afati 42 dite pune. Atehere 504:42=12 puntore dhe duke llogaritur stafin drejtues (Adminstrator 1, Inxhinier ndertimi 1, Inxhinier gjeodet 1 dhe Financieri 1) eshte gjykuar per te kerkuar 16 punonjës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesia	Sasi	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtes minimalisht 15 ton	copë	2	Në pronësiose me qira
2	Kamjonçinë me kapacitet mbajtës 3 – 5 Ton	copë	1	Në pronësiose me qira
3	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësiose me qira
4	Rul hekur hekur mbi 10 Ton	cope	1	Në pronësi ose me qira
5	Rul gomë hekur mbi 15 Ton	copë	1	Në pronësiose me qira
6	Autobetoniere	copë	1	Në pronësiose me qira
7	Autobot uji	copë	1	Në pronësiose me qira
8	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësiose me qira
9	Grejder	cope	1	Ne pronesi ose me qira
10	Autobitumatriçe	cope	1	Ne pronesi ose me qira
11	Fabrike per prodhimin e asfaltobetoneve jo më larg se 50 km nga objekti, te pajisur me dokumentacionin ligjor perkates, dhe Licensen e QKL /kategoria B, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale asfaltbetoni shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL)	cope	1	Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi
12	Kokore	copë	8	Pronësi ose me qera
13	Kuti e ndihmes se shpejte	copë	2	Pronësi ose me qera
14	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	copë	4	Pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm) dhe fotot përkatëse. Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm) dhe fotot përkatëse. Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Për impiantin e asfaltobetonit që është në pronesi duhen të paraqiten kontratat e blerjes apo zhdoganimit, fotot, faturat tatimore përkatëse, leja mjedisore leshuar nga QKL si dhe dokumenta që vërtetojnë pronësinë (certifikate pasurie apo leje ndertimi). Nëse është marrë me qera/furnizim krahas dokumentacionit të mesipër duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas formularit përmbledhës së vetdeklarimit.
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Janë kërkuar këto makineri në përputhje me volumet e zërave të preventivit, llojit të punimeve si punime germimi, punime betoni etj, manualit të MPPT miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, afatit të zbatimit të kontratës dhe që gjykohen të nevojshme për realizimin e objektit në bazë të përlogartjeve të oreve të punës sipas këtij manuali. Për fabrikën e asfaltobetonit është kërkuar që të ketë distancë 50 km nga vendodhja e objektit për faktin që binderi dhe asfaltobetonit të kenë temperaturën e duhur gjatë hedhjes në objekt. Ky objekt parashikohet të zbatohet në stinën e dimrit e të pranverës dhe nisur nga faktorët atmosferikë marja e asfaltobetonit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;
- Certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015;

- Certificate ISO OHSAS 18001:2007 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose te disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018

Ne rastet e bashkimit ekonomik te operatoreve, cdo antar i grupit duhet te paraqese perkatesisht Certifikaten ISO sipas zerave te punimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas Kontates se Bashkpunimit .

Argumentimi: Eshte vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4 , VKM-në nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44,si dhe natyrës së punimeve që do realizohen. Keto certifikata jane te lidhura me natyren dhe zerat e punimeve qe do te realizohen.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikat te sistemit te menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të ”Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO OHSAS 18001:2007 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose te disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem per menaxhimin e shendetit dhe sigurise ne pune.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne zbatim te manualit te miratuar me Udhезimin nr.7, date 30.07.2021 “Per menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit me mjete elektronike”, të Agjencisë së Prokurimit Publik, Njesia e Prokurimit autorizon znj.Irini Bita per te kryer veprimet ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Njesia e Prokurimit

Irini BITA

Aristotel KOÇI

Spiro JORGJI